

Data 28.04.2025

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS Riparim i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent” e ndarë në lote**

**Loti 1: Loti 1: Angio CT, Prodhues: Siemens/ose ekuivalent, model: AS Definition**

**Loti 2: Skaner, Prodhues: GE/ose ekuivalent, model: VCT 64 sl**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi - 50000000-5**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **”Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**(TE NJËJTA PËR TË DY LOTET)**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

**b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;**

**Argumentimi:** Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.
- b. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë ***Certifikaten ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”*** ose Kompania prodhuese të jetë e certifikuar me ISO 13485 ose ekuivalente të vlefshme.”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. **Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

**Argumentim:***Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 77 te Ligjin nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar ne te cilen gjejme te percaktuar se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu ky kriter eshte bazuar dhe ne nenin 21, 22 dhe 23 te Ligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore“.*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2022, 2023 dhe 2024) ku vlera e tyre te jete jo me vogël se **40% e vlerës së fondit limit\***.

***Shënim\*:*** Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilen ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10.

*Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës;* në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: *Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara më poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; *Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. AK është e vetmja qendër terciare në RSH për këtë arsye praktika e vendosur ndër vite e cila ka rezultuar e suksesshme, është ajo e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik në tërësi.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori*

ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- a) Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa **20% e vlerës së fondit limit\* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime\* të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen artikujt.**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Shënim\*:** Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilin ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejme të përcaktuar se: **4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;** si dhe nenit 41 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është e përcaktuar se: [...]3. **Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të**

madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në perpjësim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 41 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor QSU “Nënë Tereza” Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nepermjet përvojave të duhura, që janë në perpjësim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

- b) Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën **1 (një)\*** inxhinier të çertifikuar për furnizim vendosje dhe realizim servisi për pajisje mjekësore, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, çertifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës.

*\*Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në mbështetje të shkresës nr.731/11 prot., datë 01.04.2025 “Kërkesë për Hapje Procedure” të Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, bashkëlidhur me shkresën nr. 731/10 prot., datë 25.03.2025 “Argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: **Riparim i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i**

**prodhuesit GE/ose ekuivalent” e ndarë në lote**, i ngritur me Urdhrin e Brendshëm me nr.104, datë 12.03.2025 me nr. 731/2 prot., “ Per ngritjen e komisionit per argumentimin e nevojave,perllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit me objekt **“Riparim i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent” e ndarë në lote**”, u argumentua/hartuar nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetet perkatese ne lidhje me kriteret teknike, si kriter i vendosur ne perputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne nenit 41, të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohen të gjitha kriteret e mundshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Për këtë procedure objekti i prokurimit eshte: **“Riparim i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent” e ndarë në lote**”. Ky kriter konkretisht, është vendosur në mënyrë që e gjithë procedura të bëhet nga persona të kualifikuar të cilët garantojnë zbatimin e kontratës plotësisht dhe në mënyrën e duhur, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj. Ky kriter eshte miratuar dhe vendosur nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me Kërkesat për kualifikim, në përputhje me Nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Ky kriter mbeshtetet edhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, shërbime”.Ky kriter gjen mbeshtetje ne VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, piken 4, ku percaktohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a)licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose, b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose, c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose, ç)mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes **Autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin)** për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet te jete original ose kopje e perkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshem ne momentin e hapjes se ofertave.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Shkresen nr.731/11 prot., datë 01.04.2025 “Kërkesë për Hapje Procedure” të Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, bashkëlidhur me shkresën nr. 731/10 prot., datë 25.03.2025 “Argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: **Riparim i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent” e ndarë në lote**, i ngritur me Urdhrin e Brendshëm me nr.104, datë 12.03.2025 me nr. 731/2 prot., “ Per ngritjen e komosionit per argumentimin e nevojave,perllogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit me objekt “**Riparim i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent” e ndarë në lote**”, u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, garanton mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbeshtetje te **Rekomandimit nr. 3341/I prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik”.**

- ç) OE duhet të paraqesë Autodeklarate ku garanton se në rast të shpalljes fitues, pajisjet që do rikthehet në gjëndje të plotë pune sipas parametrave të prodhuesit. OE duhet të deklarojë gjithashtu se pjesët e këmbimit të nevojshme do të jenë të çertifikuara FDA ose CE apo Direktivave (MDD ose MDR) 93/42 EEC ose EU Regulation 2017/745 (sipas azhornimeve përkatëse), sipas vlefshmërisë dhe aplikimit të tyre në objektin e prokurimit.

**Argumentimi:** Kriteret e vendosura ne DST ne pikat d) jane vendosur nga anetaret e NjP qe kane specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ne nenin 41 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“,i ndryshuar,

rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive“, si dhe referuar Relacion për argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike nr. 731/10 prot., datë 25.03.2025 “Argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt **“Riparim i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent” e ndarë në lote**”, nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës “Për hapje procedure” nr.731/11 prot., datë 01.04.2025 të Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike.

### **Shenim për operatorët ekonomik:**

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 9 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për këto pika do të jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.
- Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.



Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 6 .

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOT 1 : Angio CT, Prodhues: Siemens/ose ekuivalent, model: AS Definition

**Shërbimi i kërkuar për pajisjen mjekësore Angio CT, Prodhues: Siemens/ose ekuivalent, model: AS Definition:**

Nr.	Produkti	Sasia (copë)
1	Furnizim me invertera të gjeneratorit të tensionit të lartë	2

**Furnizim vendosje me invertera të gjeneratorit të tensionit të lartë /per invertera ose ekuivalent,**

- **Konvertimi i tensionit te vazhduar :565 V**
- **Tensioni alternativ me frekuene: 20-70 KHZ**

LOT 2 : Skaner, Prodhues: GE/ose ekuivalent, model: VCT 64 sl

**Shërbimi i kërkuar për pajisjen mjekësore Skaner, Prodhues: GE/ose ekuivalent, model: VCT 64 sl:**

Nr.	Produkti	Sasia (copë)
1	Furnizim me module të dedektorit	2

**Furnizim vendosje Modul dedektor per Dedektor HDAS64 ose ekuivalent per pajisjen Skaner VCT Lightspeed 64sle.**

- **Modul dedektori per Pajisjen, Dedektor me numër 24/51**
- **FRDM VCT Lightspeed ose ekuivalent**
- **Kompatibel me dedektor HDAS64 SL ose ekuivalent**

- **Te jete i klasit 2/ ose 3**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Shkreses nr.731/11 prot..., datë 01.04.2025 “Kërkesë për Hapje Procedure” të Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, bashkëlidhur me shkresën nr. 731/10 prot., datë 25.03.2025 “Argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: **Riparim i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent**” e ndarë në lote, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38 të Ligjin nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar nenin 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shtojca 7.

## **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

### **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Lot 1:** Angio CT, Prodhues: Siemens/ose ekuivalent, model: AS Definition

Shërbimet që kërkohen: **Shërbimi i kërkuar për pajisjen mjekësore Angio CT, Prodhues: Siemens/ose ekuivalent, model: AS Definition:**

<b>Nr.</b>	<b>Produkti</b>	<b>Sasia (copë)</b>
1	Furnizim me invertera të gjeneratorit të tensionit të lartë	2

**Lot 2:** Skaner, Prodhues: GE/ose ekuivalent, model: VCT 64 sl

**Shërbimi i kërkuar për pajisjen mjekësore Skaner, Prodhues: GE/ose ekuivalent,model: VCT 64 sl:**

<b>Nr.</b>	<b>Produkti</b>	<b>Sasia (copë)</b>
1	Furnizim me module të dedektorit	2

**Afatet e ekzekutimit: Brenda 10 ditësh nga nënshkrimi i kontratës.**

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Spitali Qendror në QSU “Nënë Tereza”

**Sasia dhe Grafiku i levrimit** janë vendosur në bazë të Shkresës nr.731/11 prot., datë 01.04.2025 “Kërkesë për Hapje Procedure” të Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, bashkëlidhur me shkresën nr. 731/10 prot., datë 25.03.2025 “Argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: **Riparim i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent**” e ndarë në lote.

**Shtojca 8.**

### **TERMAT E REFERENCES**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **Riparimi i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent**

**Lot 1: Angio CT, Prodhues: Siemens/ose ekuivalent, model: AS Definition**

**Shërbimi i kërkuar për pajisjen mjekësore Angio CT, Prodhues: Siemens/ose ekuivalent, model: AS Definition:**

<b>Nr.</b>	<b>Produkti</b>	<b>Sasia (copë)</b>
1	Furnizim me invertera të gjeneratorit të tensionit të lartë	2

#### **Shërbimi i kërkuar:**

Pas instalimeve, konfigurimeve, riparimeve apo ndërhyrjeve të tjera të kryera, shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë kalibrimet e nevojshme, verifikimin e parametrave sipas rekomandimeve të prodhuesit, për garantimin e funksionimit normal të pajisjeve.

Duhet të mbahet një procesverbal (i standartizuar nga AK) apo Raport Servisi, formati i të cilit miratohet dhe unifikohet nga AK, që përshkruan në mënyrë të detajuar dhe të qartë pjesët e zëvendësuara me të dhënat teknike (serial number, model etj), kalibrimet dhe provën e funksionit. Raporti i Servisit, i cili do përshkruajë në mënyrë të detajuar shërbimet e kryera, duhet të firmoset nga Shefi i Shërbimit ku ndodhet pajisja ose persona të autorizuar prej tij (staf mjekësor përdorues i pajisjes), specialist/ përgjegjës i Sektorit të Inxhinierisë Klinike dhe tekniku apo inxhinieri i operatorit ekonomik fitues në këtë procedurë.

Pjesët e zëvendësuara duhet të jenë të reja, origjinale, në gjendje pune dhe të përshtatshme për pajisjet mjekësore

**Detyrat:** Realizimin e furnizim vendosjes së pjesëve përberëse të pajisjeve mjekësore pjesë e kësaj procedure prokurimi, instalimin, konfigurimin kalibrimin dhe testimin për të rikthyer në **gjendje të plotë funksionale** pajisjen mjekësore **Angio CT i prodhuesit Siemens/ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent**

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:** PAI Polivalent në QSU “Nënë Tereza”.

**Garancia per pjese e nderruar duhet te jete 1(nje) vit.**

**Afatet e ekzekutimit:** Shërbimi i furnizim vendosjes dhe rikthimit në gjendje të plotë funksionale të pajisjeve mjekësore pjesë e kësaj procedure prokurimi do të kryhet maksimumi për 10 ditë kalendarike **pas lidhjes së kontratës.**

**Lot 2: Skaner, Prodhues: GE/ose ekuivalent, model: VCT 64 sl**

**Shërbimi i kërkuar për pajisjen mjekësore Skaner, Prodhues: GE/ose ekuivalent,model: VCT 64 sl:**

<b>Nr.</b>	<b>Produkti</b>	<b>Sasia (copë)</b>
1	Furnizim me module të dedektorit	2

**Shërbimi i kërkuar:**

Pas instalimeve, konfigurimeve, riparimeve apo ndërhyrjeve të tjera të kryera, shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë kalibrimet e nevojshme, verifikimin e parametrave sipas rekomandimeve të prodhuesit, për garantimin e funksionimit normal të pajisjeve.

Duhet të mbahet një procesverbal (i standartizuar nga AK) apo Raport Servisi, formati i të cilit miratohet dhe unifikohet nga AK, që përshkruan në mënyrë të detajuar dhe të qartë pjesët e zëvendësuara me të dhënat teknike (serial number, model etj), kalibrimet dhe provën e funksionit. Raporti i Servisit, i cili do përshkruajë në mënyrë të detajuar shërbimet e kryera, duhet të firmoset nga Shefi i Shërbimit ku ndodhet pajisja ose persona të autorizuar prej tij (staf mjekësor përdorues i pajisjes), specialist/ përgjegjës i Sektorit të Inxhinierisë Klinike dhe tekniku apo inxhinieri i operatorit ekonomik fitues në këtë procedurë.

Pjesët e zëvendësuara duhet të jenë të reja, origjinale, në gjendje pune dhe të përshtatshme për pajisjet mjekësore

**Detyrat:** Realizimin e furnizim vendosjes së pjesëve përberëse të pajisjeve mjekësore pjesë e kësaj procedure prokurimi, instalimin, konfigurimin kalibrimin dhe testimin për të rikthyer në **gjendje të plotë funksionale** pajisjen mjekësore **Angio CT i prodhuesit Siemens/ose ekuivalent**

**dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent**

**Vendi i kryerjes së shërbimeve:** PAI Polivalent në QSU “Nënë Tereza”.

**Garancia per pjese e nderruar duhet te jete 1(nje) vit.**

**Afatet e ekzekutimit:** Shërbimi i furnizim vendosjes dhe rikthimit në gjendje të plotë funksionale të pajisjeve mjekësore pjesë e kësaj procedure prokurimi do të kryhet maksimumi për 10 ditë kalendarike **pas lidhjes së kontratës.**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Shkreses nr.731/11 prot..., datë 01.04.2025 “Kërkesë për Hapje Procedure” të Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, bashkëlidhur me shkresën nr. 731/10 prot., datë 25.03.2025 “Argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: **Riparim i pajisjes mjekësore Angio CT i prodhuesit Siemens/ ose ekuivalent dhe i pajisjes Skaner i prodhuesit GE/ose ekuivalent” e ndarë në lote**, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38 të Ligjin nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar nenin 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**NJËSIA E PROKURIMIT:**